

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Syte" rusë mbi Amerikën 14 satelitë spiunë mbi bazën e SHBA para sulmit iranian
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/bota/syte-ruse-mbi-ameriken-14-satelite-spiune-mbi-bazen-e-shba-para-i1185296
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 16:21:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 16:18:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	973e23a85469d6a445e54055aa9c4fd01087fe92e9b9ee28c8eef7411c389dcf
TEKSTI	428e0c9fb897919f18de0d95b560cf50dc4c7b569fd752a976ee970be4fd9bae
PAMJA	622089426d26aa4d1f240da42c98d8e3fd8b5796a9173a67303e031d917fa8c7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b3349b1379e19404a5b8f9105a9c5d636b3014b4a65662532141bd61e045b838
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	565d15129a3a8f2c33135848c08d2b7db1d78c2d7a3d3b93f84b73cbde96b20f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b3349b1379e19404a5b8f9105a9c5d636b3014b4a65662532141bd61e045b838>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Sytë” rusë mbi Amerikën 14 satelitë spiunë mbi bazën e SHBA para sulmit iranien

Nga Erjon Dervishi
17 Shtator 2026, 18:18 | Bota



14 satelitë spiunë rusë, kanë fotografuar një bazë ushtarake amerikane në Arabinë Saudite, dy ditë para se Irani ta shkatërronte atë.

Qëndrimi dhe marrja e koordinatave, u dha atyre një akses të gjerë të të dhënave. Kështu bërën me dije zyrtarët amerikanë dhe atë ndërkombëtar të inteligjencës. Sipas këto të dhëna ndihmuan Iranin të realizonte disa sulme precize ndaj aseteve amerikane.

Ky është Sateliti “Cosmos 2573”. Një nga satelitët elitë spiun rus, e cila aktualisht po mbledh të dhëna inteligjente në të gjithë botën.

CNN ka mësuar se këta satelitë kanë dhënë për Iranin disa avantazhe të konsiderueshme në luftën kundër aseteve amerikane. Madje të dhënat u japin mundësi iranienëve të shikojnë edhe detajet e brendshme të bazave amerikane.

Sipas të dhënave të CNN, këta satelitë po japin informacione për Iranin duke ndihmuar ata të sulmojnë me precizion të lartë.

Bashkëpunimi dhe sinergjia më e dukshme mes satelitëve rus dhe raketave iraniane ka ndodhur pikërisht në bazën amerikane “Prince Sultan”

Më pas vijnë lajmet e fundit, Irani godet bazën amerikane. Media shtetërore Iraniane, jep këtë imazh që tregon sulmin në bazën amerikane në afërsi të Riadit.

Sulmi ndodhi në 27 mars. Shtetet e Bashkuara kanë pasur një prezencë prej dekadash në këtë bazë. Sipas burimeve tona, sateliti rus luajti një rol vital në këto sulme, e cila hodhi në erë bazën dhe plagosi 12 amerikanë pjesë e personelit.

Ne nuk kemi akses në imazhet satelitore ruse, por kemi parë datat dhe kemi aksesuar pamjen e tyre mbi bazat tona me ndihmën e teknologjisë dhe projektit “Aurora”. Këtu shfaqet gjithashtu “Cosmos 2573” vetëm dy ditë përpara sulmeve. Ajo fluturon mbi bazë së bashku me 13 satelitë të tjerë rus.

Analizat tona tregojnë se këta satelitë kanë lëvizur në mënyrë perfekte dhe kanë pasur një pamje perfekte për të mbledhur të dhëna të rëndësishme dhe të shumta. Secili nga këta satelitë kontribuon në pjesë të ndryshme të fushës së inteligjencës.

Këto janë 8 sinjale të satelitëve. Ata mund të interceptojnë radiot, radarët, duke u mundësuar atyre të lokalizojnë bazat që mund të goditen nga raketat.

Këta dy janë satelitë infra të kuq. Ata identifikojnë gjurmët termike, të tilla si ato që gjenerohen nga sistemet raketore të lëshimit.

TE FUNDIT

🕒 Kategoria Superiore, Vllaznia kërkon fitoren e parë përballë Teutës

Kurti takon kreun e PDK pas dënimit të ish-krerëve të UÇK: Vendimi duhet ndryshuar në shkallën e Apelit

Bojkotohet mësimi, mikrobuzi me 20 vende për 45 nxënës dhe mësues

"Arbitrazhi na dha të drejtë" MIE: Kontrata koncesionare për aeroportin e Vlorës do të anulohet

MË TË VIZITUARAT

Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës

"Fashisti" del nga burgu! Numri dy i "Agimit të artë" premtori kthimin në parl...

E rëndë në Velipojë, 82-vjeçari kosovar humb jetën në det

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

Dhe, së fundi, janë tre satelitë të radarit me aperturë sintetike, të njohur si SAR. Këta satelitë janë në gjendje të depërtojnë përmes reve dhe të funksionojnë edhe në kushtet e errësirës, si dhe të identifikojnë ndryshime fizike në terren. Për shembull, ata mund të evidentojnë zhvendosjen e një aseti me vlerë të lartë dhe të lëvizshëm, siç është ky avion: Sistemi Ajror i Paralajmërimit dhe Kontrollit, i cili përbën, në një kuptim, “sytë e Amerikës në qiell” në Lindjen e Mesme.

Në mënyrë thelbësore, avioni nuk ishte vendosur në pozicionin ku ndodhej para fillimit të luftës.

Më 27 mars, Irani e shkatërroi atë, një avion me vlerë prej qindra milionë dollarësh dhe që është jashtëzakonisht i vështirë për t’u zëvendësuar.

Sipas burimeve tona, shkalla e dëmit të shkaktuar në bazë dhe saktësia e goditjeve do të kishin qenë pothuajse të pamundura pa përdorimin e inteligjencës gjeohapësinore ruse.

Tamara Qiblawi, CNN: Dhe ky nuk është një incident i izoluar. Aktualisht ekziston një debat ndërmjet zyrtarëve amerikanë lidhur me shkallën e ndikimit që ka pasur mbështetja ruse. Megjithatë, burimet tona dyshojnë gjerësisht se satelitët rusë i kanë ofruar Iranit informacione për përcaktimin e objektivave në disa raste të tjera gjatë zhvillimit të luftës, përfshirë edhe në një objekt të CIA-s në kryeqytetin saudit.

Nawaf Obaid, studiues i lartë, King’s College: Ne nuk do të ndodheshim në këtë situatë sot. Lufta nuk do të kishte arritur në pikën ku ndodhet aktualisht nëse nuk do të ishte për këto kapacitete të veçanta që rusët u vunë në dispozicion iranianëve.

Sipas ekspertëve si Dr. Nawaf Obaid, një nga arsytet përse Rusia ka ndihmuar Iranin, ndërkohë që Moska i cilëson këto pretendime si “lajme të rreme” lidhet me faktin se Shtetet e Bashkuara po bashkëpunojnë me Ukrainën në një mënyrë të ngjashme, përmes shkëmbimit të informacionit të inteligjencës, me qëllim mbështetjen e goditjeve të ngjashme me ato të përshkruara më sipër.

Nawaf Obaid, studiues i lartë, King’s College: Duhet ta shohim këtë situatë në këtë mënyrë: kjo është një kundërpërgjigje ruse ndaj Shteteve të Bashkuara, me interesa të shtuara. Përmasat e pasojave të këtij zhvillimi janë monumentale, jo vetëm për pozitën e Shteteve të Bashkuara në rajon, por edhe për arkitekturën e sigurisë së rajonit në të ardhmen. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Sulme masive mbi Kiev, Rusia godet Odesën dhe Zaporizhian, dhjetra të...



Kryeministri i Suedisë, jep dorëheqjen pas humbjes në zgjedhje



Lavrov kërcënon Europën: Nëse sulmoni Rusinë lufta tjetër do të jetë shumë e shkurtër



Sanksione më të rrepta të SHBA, Putinit nuk i lejohet më të vizitojë Trumpin



"Dëgjohe zëra nën rrënoja", bie ndërtesa në Gaza, 100 persona nuk janë gjetur



Si e ndihmon Rusia Iranin të godasë bazat amerikane

Latest Videos



Protesta në Tiranë e Prishtinë. Flamingot shkojnë në Rotterdam. 110 ditë në shesh. Çpo ndodh?



Ansambli Kombëtar niset për Koncerte në Itali. Premiera në Tiranë dhe përgatitjet e 70 vjetorit



"Ansambli i kthyer në atraksion e trend po zhvillojmë etnomuzikalet kemi hapur dimensionin artistik"



Turi Ansambli të Këngëve e Valleve në Shqipëri, Marsi: Koncertet në sheshe të hapura, bëm 12 shfaqje

Shqipëria

Aktualitet
Kronikë
Politikë
Ekonomi

Kosova

Kulturë
Sociale
Ekonomi
Politikë

Rajoni & Bota

Balkani
Bota

Argëtim


Showbiz
Lifestyle
Kapur në kamera
Teknologji

Sport

Live Euro 2024
Futboll
Sporte të tjera

Speciale A2

5 gjëra në 5 minuta
A2 CNN në Izrael
31 Minuta
A2 CNN në Ukrainë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.